VENDIM
Nr. 337, datë 5.6.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 456, DATË 29.6.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE PËR VENDOSJEN E DETYRIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK, QË DO TË ZBATOHEN NDAJ TË LICENCUARVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, TË CILËT USHTROJNË AKTIVITETIN E PRODHIMIT, TRANSMETIMIT, SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin "Për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohet ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", bashkëlidhur vendimit nr. 456, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 1, të nenit 1, shtohen fjalët "… si dhe të përcaktojë ndërveprimin ndërmjet shoqërive të mësipërme.".

2. Pas pikës 6, të nenit 3, shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

"7. Në këtë vendim, fjalët "në mënyrë proporcionale", kanë kuptimin që në rast të tepricave, sasitë e planifikuara për blerje në treg të parregulluar nga Furnizuesi i Tregut të Lirë të jenë jo më shumë se pesëdhjetë për qind e energjisë elektrike mujore të planifikuar për furnizim, duke i mundësuar Furnizuesit të Tregut të Lirë depozitimin te shoqëria publike të prodhimit të tepricave të energjisë elektrike dhe rimarrjen potenciale të tyre, me qëllim optimizimin e portofolit të dy shoqërive.".

3. Në nenin 12 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) në pikën 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. pas fjalëve "... mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ..." shtohen "... dhe furnizim në tregun e lirë ...";

ii. fjalët " ... ndërsa çmimi i shitjes për njësi miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë" zëvendësohen me " ... ndërsa metodologjia e caktimit të çmimit të furnizimit e shitjes për njësi miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë";

iii. pas paragrafit të parë shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Furnizuesi i Tregut të Lirë, për nevoja të furnizimit të klientëve të saj në treg të lirë, ka të drejtë, në mënyrë proporcionale, ta sigurojë këtë energji në treg të parregulluar dhe/ose të përdorë tepricat/depozitën nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë. Për optimizimin e çmimit të portofolit të furnizimit, profilet e blerjes orare përshtaten bazuar në pritshmërinë e arsyeshme të tregut të energjisë. Rregullat për sigurimin e energjisë elektrike nga tregu i parregulluar, duke përfshirë edhe tregun e ditës në avancë dhe/ose tepricat nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, miratohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.";

b) në pikën 4, fjalia e parë që mbyllet me " ... për t'u përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universalë", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Sasia e tepërt nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, pas mbulimit të humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe/ose furnizimit të klientëve në tregun e lirë, depozitohet në shoqërinë publike të prodhimit për t'u përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universalë.".

II. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku